

Tiranë, më 27. 03.2023

## ANKIM

**ANKUES:** Qendra “Qëndresa Qytetare”, një organizatë jofitimprurëse e regjistruar me Vendimin Nr. 1120, datë 15.09.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me seli në adresën: Rruga “Ali Pashë Gucia”, Pallati nr. 42 me adresë elektronike [qendresaqytetare@gmail.com](mailto:qendresaqytetare@gmail.com), me Drejtor Ekzekutiv Z. Rigels Xhemollari.

**OBJEKTI:** 1. Kundërshtimi i Vendimit nr. 199, datë 24.03.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 92, 171 dhe 172, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”;  
Nenet 3, 10 dhe 11, të Vendimit të Komisionit Rregullator nr. 9, datë 24.12.2020 “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencie, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”.

**DREJTUAR:** Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve.

---

Të Nderuar,

Në datën 25.03.2022, kemi marrë dijeni për Vendimin Nr. 199, datë 24.03.2023 “Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve, për shkelje administrative për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023” të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Duke mos qenë dakord me këtë vendim, për shkak se vlerësojmë se aktiviteti në fjalë përfshihet në veprimtaritë publike të ndaluara, si më poshtë:

### **I. RRETHANAT E ÇËSHTJES:**

1. Më datë 7 shkurt 2023, gjatë ditës, Ministri i Shëndetësisë Znj. Ogerta Manastirliu, së bashku me Ministrin e Drejtësisë, njëherazi dhe Drejtues Politik i Partisë Socialiste të Shqipërisë Z. Ulsi Manja, dhe Kryetarin e Bashkisë Pjerin Ndreu kanë marrë pjesë në një vizitë me Spitalin

Rajonal të Lezhës. Në orën 12:41, Znj. Manastirliu ka postuar në profilin e saj zyrtar në Facebook një video, me kohëzgjatje 9 minuta e 46 sekonda.

**1.1** Përshkrimi fillestar i këtij postimi ka qenë: “🇲🇰 Lezhë-🇲🇰 Edhe një tjetër investim për fuqizimin me aparatura mjekësore të teknologjisë së lartë të Spitalit të Lezhës, teksa bëhemi gati për investimin transformues të godinës qendrore të këtij spitali rajonal🇲🇰🇲🇰 Pas ndërtimit të Spitalit të Kurbinit, fillimit të investimit për rindërtimin e Spitalit të Mirditës dhe këtë vit me Spitalin e Lezhës, finalizohen investimet për shërbimin spitalor për qarkun e Lezhës, me standarde europiane🇲🇰🇲🇰 #TëBashkuarJoTëNdarë🇲🇰🇲🇰 #ShqipëriaEArdhmjaJonë🇲🇰🇲🇰 #SkaKohëPërPushim🇲🇰🇲🇰” [Prova nr. 1 – Postimi fillestar i Znj. Ogerta Manastirliu në rrjetet sociale].

**1.2** Në orën 13:00, të së njëjtës datë, përmbajtja e postimit është ndryshuar në: “🇲🇰 Në spitalin rajonal të Lezhës, me Ulsiun, Pjerinin dhe Ardianin, për një tjetër investim në pajisje biomjekësore për fuqizimin e shërbimit të radiologjisë, të aparaturës së re Dexa, për matjen e densimetrisë kockore, e instaluar tashmë në poliklinikën e spitalit. Pas ndërtimit të Spitalit të Kurbinit, fillimit të investimit për rindërtimin e Spitalit të Mirditës, këtë vit nisim investimin për rehabilitimin e Spitalin Rajonal të Lezhës, duke përmyllur deri në 2025 investimet në infrastrukturën spitalore të qarkut Lezhë🇲🇰🇲🇰 #TëBashkuarJoTëNdarë🇲🇰🇲🇰 #ShqipëriaEArdhmjaJonë🇲🇰🇲🇰 AL #SkaKohëPërPushim🇲🇰🇲🇰🇲🇰🇲🇰” [Prova nr. 2 – Ndryshimi i parë në përmbajtjen e postimit].

**1.3** Në të njëjtën orë, të së njëjtës datë, përmbajtja e postimit është ndryshuar sërish në: “🇲🇰 Lezhë - 🇲🇰 Edhe një tjetër investim për fuqizimin me aparatura mjekësore të teknologjisë së lartë të Spitalit të Lezhës, teksa bëhemi gati për investimin transformues të godinës qendrore të këtij spitali rajonal🇲🇰🇲🇰 Pas ndërtimit të Spitalit të Kurbinit, fillimit të investimit për rindërtimin e Spitalit të Mirditës dhe këtë vit me Spitalin e Lezhës, finalizohen investimet për shërbimin spitalor për qarkun e Lezhës, me standarde europiane🇲🇰🇲🇰 #TëBashkuarJoTëNdarë🇲🇰🇲🇰 #ShqipëriaEArdhmjaJonë🇲🇰🇲🇰 AL #SkaKohëPërPushim🇲🇰🇲🇰🇲🇰🇲🇰” [Prova nr. 3 – Ndryshimi i dytë në përmbajtjen e postimit].

**1.4** Në orën 13:17, të së njëjtës datë, përmbajtja e postimit është ndryshuar për herë të tretë në: “🇲🇰 Lezhë - 🇲🇰 Bashkë me Ulsiun, Pjerinin dhe Ardianin për një tjetër investim në shërbimin e radiologjisë në spitalin rajonal të Lezhës ku për herë të parë është instaluar pajisja Dexa, për matjen e densimetrisë kockore në ambientet e poliklinikës së spitalit. Pas ndërtimit të Spitalit të Kurbinit, fillimit të investimit për rindërtimin e Spitalit të Mirditës, këtë vit nisim investimin e ri për rehabilitimin e godinës qendrore të Spitalit rajonal të Lezhës, duke përmbushur kështu hap pas hapi angazhimet tona për rritjen e standardeve të shërbimit spitalor në qarkun e Lezhës🇲🇰🇲🇰 #TëBashkuarJoTëNdarë🇲🇰🇲🇰 #ShqipëriaEArdhmjaJonë🇲🇰🇲🇰 #SkaKohëPërPushim🇲🇰🇲🇰🇲🇰” [Prova nr. 4 – Ndryshimi i tretë në përmbajtjen e postimit].

1.5 Në orën 16:27, të së njëjtës datë, përmbajtja e postimit është ndryshuar për here të katërt në: “🇲🇰 Lezhë - 🇲🇰 Bashkë me Ulsiun, Pjerinin dhe Eduartin për një tjetër investim në shërbimin e radiologjisë në spitalin rajonal të Lezhës ku për herë të parë është instaluar pajisja Dexa, për matjen e densimetrisë kockore në ambientet e poliklinikës së spitalit. Pas ndërtimit të Spitalit të Kurbinut, fillimit të investimit për rindërtimin e Spitalit të Mirditës, këtë vit nisim investimin e ri për rehabilitimin e godinës qendrore të Spitalit rajonal të Lezhës, duke përmbushur kështu hap pas hapi angazhimet tona për rritjen e standardeve të shërbimit spitalor në qarkun e Lezhës 🇲🇰 #TëBashkuarJoTëNdarë 🇲🇰 #ShqipëriaEArdhmjaJonë 🇲🇰 #SkaKohëPërPushim 🇲🇰”  
[Prova nr. 5 – Ndryshimi i katërt në përmbajtjen e postimit].

2. Gjatë këtij takimi, siç rezulton nga video, Znj. Manastirliu, ndër të tjera, është shprehur se: “Ne kemi patur një prioritet, fuqizimin e rrjetit spitalor në Qarkun e Lezhës”; “Jemi duke filluar dhe kemi përfunduar investime të rëndësishme”; “Një tjetër lajm i mirë për qytetarët lezhjanë është rehabilitimi i godinës qendrore të Spitalit” etj.

3. Më datë 8 shkurt 2023, në faqen zyrtare të Ministrisë së Shëndetësisë është publikuar lajmi me titull “Manastirliu: Gati investimi madhor për transformimin e spitalit rajonal të Lezhës”.<sup>1</sup> Përmbajtja e këtij lajmi është si vijon: “*Prioritet fuqizimi i shërbimit spitalor në të gjithë qarkun e Lezhës. Kemi përfunduar Spitalin e Laçit, kemi filluar punën për rehabilitim në Spitalin Bashkiak të Mirditës dhe tashmë jemi gati për investimin në spitalin e Lezhës*’.<sup>7</sup> Shkurt, Lezhë- Ministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ogerta Manastirliu, bashkë me drejtuesin politik të qarkut Lezhë, Ministrin e Drejtësisë, Ulsi Manja dhe Kryetarin e Bashkisë Pjerin Ndreu, kanë parë nga afër investimet në Spitalin Rajonal të Lezhës, duke bërë me dije investimin madhor që fillon këtë vit për rikonstruksionin e godinës qendrore të këtij spitali. ‘Jemi këtu për të dhënë një lajm të mirë për qytetarët lezhjanë, fillimin e një investimi të rëndësishëm për rehabilitimin e godinës qendrore të Spitalit Rajonal të Lezhës, një investim i cili do të përmirësojë radikalisht shërbimet e urgjencës, patologjisë, pediatriisë dhe një seri shërbimesh që janë brenda korpusit qendror të këtij spitali’, - beri me dije Manastirliu. Ndërkohë Spitali Rajonal i Lezhës është pajisur me aparaturën e re DEXA, duke shtuar një shërbim të ri për qytetarët. ‘Pajisja më e re për matjen e densimetrisë konckore, vërtetë ka përmirësuar shërbimet dhe ka mbyllur një cikël të shërbimeve sa i përket imazherisë në këtë spital’, tha Manastirliu. Ministri Drejtësisë dhe drejtuesi politik i PS në Lezhë, Ulsi Manja ka vlerësuar punën e stafëve mjekësore të këtij spitali, teksa vuri theksin tek investimet bashkëkohore në këtë spital. ‘Spitali i Lezhës do të ofrojë të gjitha shërbimet cilësore. Posaçërisht këtu në Lezhë është meritë e mjekëve dhe infermierëve që shërbejnë në këtë strukturë dhe që në vijim do të kenë në dispozicion një sistem spitalor modern dhe pajisjet e teknologjisë së fundit’, - tha Manja. Pas ndërtimit të Maternitetit të ri të Lezhës, investimi në godinën qendrore të Spitalit Rajonal Lezhë përmbyll ciklin e investimit në këtë spital. Investimi do

<sup>1</sup> Për më shumë shih: <https://shendetesia.gov.al/manastirliu-gati-investimi-madhor-per-transformimin-e-spitalit-rajonal-te-lezhes/>, aksesuar online më 10.2.2023.

të përfshijë godinën qendrore të spitalit, sipërfaqje ndertimi rreth 4.000 m<sup>2</sup>, ku përfshihen të gjithë shërbimet me shtretër, reanimacioni, urgjencat peadiatrike dhe ato për të rritur, terapia intensive, pediatria, kirurgjia, me një kapacitet 117 shtretër. Me ndërtimin e Spitalit të Kurbinut, fillimit të punimeve për Spitalin e Mirditës, investimi i ri në Spitalin e Lezhës përmbyll ciklin e investimeve të shërbimit spitalor në këtë qark.” [Prova nr. 6 – Screenshot “Lajmi i publikuar në portalin zyrtar të Ministrisë së Shëndetësisë].

4. Në referim të shkresës nr. 936.1 prot, datë 22.03.2023, të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, kjo e fundit ka pretenduar si vijon: “Sqarohet se ky aktivitet nuk ka qenë i hapur për publikun dhe nuk ka qenë me pjesëmarrjen e medias, por pasqyrohet në rrjetet sociale të Ministres, dhe është lehtësisht i aksesueshëm nga mediat dhe kushdo tjetër. Gjithashtu, theksojmë se promovimi i investimeve me fonde të vendosura në dispozicion përpara datës 13 Janar 2023, nuk përfshihet në kategorinë e veprimtarive të ndaluara të përcaktuara në vendimin e datës nr. 9, datë 24.12.2020, si dhe fjala e pjesëmarrësve në asnjë rast nuk ka pasur ngjyrimë partiakë. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale mbetet në dispozicion për çdo informacion shtesë që mund të kërkohet nga ana e Institucionit tuaj.”

5. Me Vendimin nr. 199, datë 24.03.2023, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vendosi: “1. Pushimin e procedimit administrativ ndaj: p) Zj. Ogerta Manastirliu, Ministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; 2. Tërheqje vëmendje për marrjen e masave të menjëhershme, për raportimin e veprimtarive publike; 3. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet postës elektronike; 4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve; 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij”.

6. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në faqen 18, të Vendimit, shprehet se: “Për sa i përket veprimtarive publike, në kuptim të nenit 3, pika 1.1, nënpika “b”, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, veprimtari të ndaluara për tu promovuar janë veprimtaritë publike, për të cilat janë vënë rishtazi apo posaçërisht në dispozicion, apo janë transferuar fonde publike jo sipas planit buxhetor të miratuar, në periudhën 4 (katër) muaj para datës së zgjedhjeve. Në këto kushte, veprimtaria e zhvilluar nga pala e denoncuar në këtë proces nuk përbën veprimtari të ndaluar për t’u promovuar”.

## II. E DREJTA E APLIKUESHME:

7. Ligji nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”:

- (i) **Neni 91 “Ndalimi i përdorimit të burimeve publike në mbështetje të subjekteve zgjedhore”** parashikon: “1. Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të

kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia. 2. Në kuptim të këtij neni, “burime” quhen asetet e luajtshme dhe të paluajtshme, të parashikuara në nenin 142 të Kodit Civil, si dhe çdo burim njerëzor i institucionit. Me përdorim të “burimeve njerëzore” kuptohet përdorimi i detyruar në fushatë zgjedhore i administratës së institucionit brenda orarit të punës për qëllime zgjedhore, si dhe përdorimi i detyruar dhe i organizuar brenda orarit mësimor i nxënësve të sistemit shkollor parauniversitar në fushatë zgjedhore. Me përdorim të burimeve njerëzore kuptohet gjithashtu premtimi ose ofrimi i përfitimeve nëpunësve publikë, ose nxënësve për të marrë pjesë në veprimtari që lidhen me fushatën zgjedhore jashtë orarit të punës ose mësimor, si dhe ushtrimi i presionit ndaj tyre për këtë qëllim.”

- (ii) **Neni 171 “Sanksionet administrative”** parashikon: “1. Shkelja e dispozitave të këtij Kodi nga anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve osenga persona të ngarkuar me detyra, sipas këtij Kodi, kur nuk përbën vepër penale, dënohetme gjobë nga 3,000 deri në 90,000 lekë.”

8. Vendimi i Komisionit Rregullator nr. 9, datë 24.12.2020 “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”:

- (i) **Neni 3 “Veprimtari të ndaluara”** parashikon: “1. Në zbatim të këtij vendimi: 1.1 “veprimtari të ndaluara për t’u promovuar” janë veprimtaritë publike sipas përkufizimit të nenit 2, të këtij vendimi, për të cilat janë vënë rishtazi apo posaçërisht në dispozicion, apo janë transferuar fonde publike jo sipas planit buxhetor të miratuar, në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve dhe qëë përfshijnë: b) mbështetjen dhe promovimin e projekteve dhe/ose të investimeve, kombëtare ose vendore, me karakter social dhe ekonomik, si edhe ato në funksion të mbrojtjes dhe ruajtjes së mjedisit, të shëndetit, të kulturës, rinisë, sporteve dhe të arsimit publik në të gjitha nivelet, si dhe të infrastrukturës, në shërbim të interesit publik”.
- (ii) **Neni 10 “Sanksionet administrative”** parashikon: “1. Në rastet kur subjektet e parashikuara në pikën 4, të nenit 4, të këtij vendimi, nuk raportojnë, raportojnë pjesërisht ose zhvillojnë veprimtarinë, pavarësisht ndalimit të bërë nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, kur shkelja nuk përbën

*vepër penale, dënohen nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me gjobë nga 3000 (tremijë) deri në 90 000 (nëntëdhjetë mijë) lekë, sipas nenit 171, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë".*

#### 9. Vendime:

- Vendimi nr. 19, datë 31 maj 2022 i Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve;
- Vendimi nr. 23, datë 14 shtator 2022 i Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve.

### III. ANALIZA LIGJORE:

#### A. *Në lidhje me përdorimin e burimeve publike:*

7. Në referim të pikës 2, të nenit 91, të Kodit Zgjedhor, burime publike quhen asetet e luajtshme dhe të paluajtshme, të parashikuara në nenin 142, të Kodit Civil, si edhe çdo burim njerëzor i institucionit. Këto burime, si rregull, nuk mund të përdoren apo të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve. Në zbatim të pikës 5, të nenit 91, të Kodit Zgjedhor që kërkon nxjerrjen e udhëzimeve për të përcaktuar përdorimin dhe shpërdorimin e burimeve publike, Komisioni Rregullator në vendimin nr. 9/2020, ka përcaktuar, ndër të tjera, se ministri e ka të ndaluar të drejtobjë, marrë pjesë apo të kontribuojë në çfarëdo formë, në veprimtari publike të ndaluara sipas këtij ligji. Kështu, në mbështetje të gjërmës "b", të nënpikës 1.1, të pikës 1, të nenit 3, të vendimit nr. 9/2020, të Komisionit Rregullator, ndalohen të promovohen veprimtaritë publike që mbështesin dhe promovojnë projekte apo investime, kombëtare apo vendore, me karakter social, dhe ekonomik, si dhe ato në funksion të shëndetësisë. Gjithashtu, sipas gjërmës "c", të nënpikës 1.3, të pikës 1, të nenit 3, të vendimit nr. 9/2020, veprimtari të ndaluara janë edhe ato që përfshijnë vënien në dispozicion të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme të parashikuara në nenin 142 të Kodit Civil, për qëllime zgjedhore.

8. Në rastin konkret, ndryshe nga sa pretendon Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, nështë e qartë se kemi të bëjmë me një veprimtari publike të ndaluar për t'u promovuar pasi i gjithë aktiviteti i organizuar nga Ministria e Shëndetësisë, me prezencën e Ministrit të Shëndetësisë, drejtuesit politik të PS-së në Qarkun e Lezhës, njëherazi edhe Ministër i Drejtësisë, dhe Kryetarit të Bashkisë Z. Pjerin Ndreu. Ministri i Shëndetësisë Znj. Manastirliu e ka pranuar natyrën promovuese të investimeve të kësaj vizite në Spitalin Rajonal të Lezhës duke folur mbi investimet që planifikohen të kryhen në këtë spital, por edhe në spitalet e tjera të qyteteve si ai i Kurbinit dhe i Mirditës. Natyra politike e këtij aktiviteti, që ka përdorur ambientet e Spitalit Rajonal të Lezhës, i cili në vetvete përbën një burim publik në kuptim të nenit 91, të Kodit Zgjedhor, është mëse e qartë dhe vërehet nga prania e drejtuesit politik të Partisë Socialiste të Shqipërisë në këtë veprimtari. Edhe nga interpretimi gramatikor e logjik i vetë njoftimit të publikuar në faqen zyrtare

të Ministrisë së Shëndetësisë, është e qartë se prania e Z. Ulsi Manja nuk ka qenë në cilësinë e tij si Ministër Drejtësie, por në cilësinë e tij si funksionar politik. Kjo rezulton nga fjalia “7 Shkurt, Lezhë- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ogerta Manastirliu, bashkë me drejtuesin politik të qarkut Lezhë, Ministrin e Drejtësisë, Ulsi Manja”, pasi përmendja e funksionit “drejtues politik” në fillim, vë theksin tek ky pozicion, ndërsa përmendja e funksionit “Ministrin e Drejtësisë” vihet në funksion të tregimit se drejtuesi politik i qarkut Lezhë mban edhe një tjetër funksion.

9. Në vijim, përdorimi i termave “investim transformues”; “investim madhor që, fillon këtë vit”; “faza e dytë e investimit në Spitalin Rajonal” etj. nuk bën asgjë tjetër, përveçse qartëson edhe më shumë natyrën e veprimtarisë së zhvilluar në Spitalin Rajonal të Lezhës, veprimtari, e cila, në referim të pikës 1, të nenit 91, të Kodit Zgjedhor, bie në kuptimin e veprimtarive publike të ndaluara për t’u promovuar pasi qartësisht, synojnë mbështetjen e Partisë Socialiste të Shqipërisë, si një nga subjektet zgjedhore pjesëmarrëse në zgjedhjet e datës 14 maj 2023.

10. Interpretimi i bërë nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve se deklaratimet e bëra nga personat prezent lidhen me zhvillimin e politikave e të strategjive shtetërore në fushën e shërbimeve të kujdesit shëndetësor është tërësisht i gabuar. Në vlerësimin tonë, një interpretim i tillë mund të pranohej për subjekte që kanë ndikim në hartimin, zhvillimin dhe miratimin e politikave shtetërore në fushën e shërbimeve të kujdesit shëndetësor, por kur deklarime të tilla bëhen nga persona politikë, të cilët nuk kanë asnjë rol në hartimin e këtyre politikave shtetërore, ato kurrësi nuk mund të konsiderohen si deklarata që lidhen me politika shtetërore.

11. Gjithashtu, pretendimet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale se “*ky aktivitet nuk ka qenë i hapur për publikun dhe nuk ka qenë me pjesëmarrjen e medias, por pasqyrohet në rrjetet sociale të Ministres, dhe është lehtësisht i aksesueshëm nga mediat dhe kushdo tjetër*”, janë tërësisht të pabazuara në ligj dhe si të tilla, duhet të rrëzoheshin nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Kjo pasi sikundërse është shprehur dhe Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve në vendimin nr. 23, datë 14 shtator 2022, që veprimtaria të quhet publike, ajo nuk duhet domosdoshmërisht të jetë miting, tubim, mbledhje apo grumbullim i thirrur dhe i organizuar me synim pjesëmarrjen e publikut. Mjafton që ajo të jetë e “hapur”, domethënë të mos zhvillohet “pas dyerve të mbyllura”. Nuk ka nevojë që publiku apo media të thirren, të ftohen apo të mobilizohen për të marrë pjesë në veprimtari që ajo të quhet publike. Mjafton që ata të kenë akses dhe të mos ndalohen kur i qasen asaj. Nga ana tjetër, veprimtaria bëhet publike sipas kuptimit të kësaj dispozite, edhe në rastet kur ajo zhvillohet “pas dyerve të mbyllura”, por ama synon dhe realizon në fakt informimin e publikut për temat, diskutimet dhe përfundimet e agjendës së saj. Njëherazi, veprimtaria nuk mund të konsiderohet si e mbyllur për publikun, pasi siç rezulton qartë dhe nga video e publikuar nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në videon në fjalë shfaqen edhe pacientë, të cilët përfitojnë nga shërbimet shëndetësore.

12. **Konkluzion:** Përsa më sipër, organizimi nga ana e Ministrit të Shëndetësisë të një vizite në Spitalin Rajonal të Lezhës, duke përmendur dhe promovuar investimet e kryera deri më tani dhe investimet që planifikohen të kryhen në vijim; si edhe pjesëmarrja e drejtuesit politik të PSSH-së në këtë aktivitet, vërtetojnë katërcipërisht se nga ana e Ministrit të Shëndetësisë janë përdorur burimet publike në mbështetje të Partisë Socialiste dhe për rrjedhojë, Ministria e Shëndetësisë duhet të gjendet përgjegjëse për shkeljen e kryer.


#### IV. KONKLUZIONE:

13. Përsa më lart, mbështetur në nenin 91, pikat 1, 2 dhe 6, të nenit 92 dhe pikën 1, të nenit 171, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë; nenin 3, pikat 3 dhe 4, të nenit 4 dhe pikën 1, të nenit 10, të Vendimit të Komisionit Rregullator nr. 9/2020, përfundimisht,

#### KËRKOJMË:

1. Konstatimin e përdorimit të burimeve publike në mbështetje të Partisë Socialiste nga ana e Ministrit të Shëndetësisë, përmes mbështetjes dhe promovimit të investimeve në Spitalin e Lezhës.
2. Dënimin e Ministrit të Shëndetësisë me gjobë në vlerën 90,000 lekë.

#### Për “QËNDRESA QYTETARE”

()

Rigels XHEMOLLARI

- Prova nr. 1 – Postimi i Znj. Ogerta Manastirliu në rrjetet sociale;  
Prova nr. 2 – Postimi fillestar i Znj. Ogerta Manastirliu në rrjetet sociale;  
Prova nr. 3 – Ndryshimi i parë në përmbajtjen e postimit;  
Prova nr. 4 – Ndryshimi i dytë në përmbajtjen e postimit;  
Prova nr. 5 – Ndryshimi i tretë në përmbajtjen e postimit;  
Prova nr. 6 – Ndryshimi i katërt në përmbajtjen e postimit;  
Prova nr. 7 – Screenshot “Lajmi i publikuar në portalin zyrtar të Ministrisë së Shëndetësisë.